



EKZEMPLAR PËR NXËNËSIN

Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
GJUHË SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|

SHKOLLA FILLORE _____

VENDI _____

KOMUNA _____


NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR

Rezultatet mund të shihen në portalin **Moja srednja škola**: <http://mojasrednjaskola.gov.rs> duke vendosur numrin e veçantë identifikues të nxënësit (shifra tetëshifrore e nxënësit). Për shkak të shkarkimit të testit në Pdf format, në pjesën ku mund të shihni rezultatet e provimit përfundimtar, është e domosdoshme të vendosni shifrën e veçantë të testit.

Shifra e veçantë e testit: 628202112565

Nëse prindi/përfaqësuesi tjetër ligjor ka një llogari të hapur në portalin **Moj esDnevnik** ose ka një llogari në **Portal za elektronsku identifikaciju eID.gov.rs**, me të cilin mund të çaset në portalin **Moj esDnevnik**, atëherë përveç që mund të ketë çasje në rezultatet e testit përfundimtar, në portalin **Moja srednja škola**, mund të shfrytëzojë edhe shërbimet tjera elektronike si: paraqitja e ankesës ndaj rezultateve të testit përfundimtar, të dërgojë listën elektronike të dëshirave për regjistrim dhe paraqitjen apo aplikacionin elektronik për regjistrim në shkollë të mesme.

UDHËZIME PËR PUNË

- Testi të cilin duhet ta zgjidhësh ka **20 detyra**. Për të plotësuar testin në dispozicion ke **120 minuta**.
- Shkruaj mirë, në mënyrë qe shkrimi të jetë i lexueshëm, duke pasur kujdes që përgjigjet e tua të jenë të kuptueshme, të shkruara sipas rregullave drejtshkrimore dhe gramatikore.
- Kur të zgjedhësh detyrat tek të cilat duhet të shkruash diçka, gjithmonë përdor emërtimet e plota; shkurtesat nuk janë të lejueshme (p.sh. duhet të shkruash emri, e jo em., ose gjinore e jo gjin., ose të shkurtesa tjera të ngjashme)
- Plotëso testin me **laps kimik ngjyrë të kaltër** (gjatë punës mund të përdorësh laps të thjeshtë grafik dhe gomë).
- Përgjigja e cila është e shkruar vetëm me laps të thjeshtë grafik, laps kimik ngjyrë të zezë ose laps “shkruaj – fshij” nuk do të pranohet.
- Tek detyrat me opsione, nuk do të pranohen përgjigjet e përmirësuara.
- Bëj kujdes, sepse detyrat dallojnë për nga mënyra sipas të cilës duhet të përgjigjesh.
- Në detyrat me opsione do të marrësh 0 pikë nëse përveç përgjigjes së saktë rrethon apo nënvizon edhe ndonjë përgjigje të pasaktë.
- Mos shkruaj asgjë mbi QR kodet () , të cilët gjenden në çdo faqe të testit.

Tek disa detyra do të zgjedhësh përgjigjen e saktë ashtu që do të ngjyrosësh rrethin e duhur. Tek detyrat ku ekzistojnë më tepër përgjigje të sakta është e nevojshme të ngjyrosen më shumë rathë. Kujdesu që rrethi të jetë patjetër i ngjyrosur, sepse vetëm ashtu përgjigja do të pranohet si e pasaktë.

| SHEMBULL I RRATHËVE TË NGJYROSUR |
|--|
| Tek detyra me një përgjigje të saktë |
| Cili është kryeqyteti i Republikës së Serbisë? Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë. <input type="radio"/> Novi Sadi <input checked="" type="radio"/> Beogradi <input type="radio"/> Nishi <input type="radio"/> Krushevc |
| Tek detyra me më shumë përgjigje të sakta |
| Ngjyros rathët para shprehjes, shuma e të cilës është 5. <input checked="" type="radio"/> 2 + 3 <input type="radio"/> 1 + 2 <input checked="" type="radio"/> 4 + 1 <input type="radio"/> 2 + 4 <input type="radio"/> 3 + 5 |

- Nëse përfundon më herët testin se sa koha e paraparë, dorëzo testin dhe largohu në qetësi.

Të dëshirojmë shumë suksese në provim!

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI GJUHË SHQIPE

1. Trego çfarë lloji i tekstit është teksti i mëposhtëm:
Guidë turistike

Tirana ndodhet në lartësinë 110m mbi nivelin e detit! Ajo ndodhet në të njëjtin paralel me Napolin, Madridin e Stambollin, si dhe është në të njëjtin meridian me Budapestin dhe Krakovin. Sipërfaqja e qytetit të Tiranës është 31 km², ndërsa ajo e gjithë rrethit 1288 km². Përfshin katër qendra urbane Tiranën, Vorën, Kërrabën dhe Kamzën si dhe 150 fshatra. Lartësia mesatare e fushës së Tiranës është 521m. Dy majat më të larta të saj janë mali i Dajtit 1612 m dhe mali me Gropa 1828m.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- letrar
 joletrar

2. Përgjigju në pyetjet e mëposhtme:

- a) Sa shkronja ka alfabeti i gjuhës shqipe: _____
b) Sa zanore dhe sa bashkëtingëllore? _____
c) Shkruaj zanoret: _____

3. Lexo me vëmendje tekstin e dhënë:

Poezia e parë

Të dielën në mëngjes isha duke dremitur me kokën mbi detyrat e aritmetikës, kur e çrregulltë, marroke, ashtu si çdo gjë tjetër e Ilirit, më zgjoi trokitja e tij. Midis trokitjeve diçka thërriste me zërin e tij, që në këso rastesh i dilte tjetër farësh: as i hollë, as i trashë, por i përzier, zë koke e gryke njëkohësisht, që nuk mund të të ndillte veç për gjëra të marra.

.....

Por një ditë, pas një zënke të keqe, e ndjeva se që të dy, qoftë edhe kundër vullnetit tonë, po i afrohem greminës. Pasi i ndamë pullat, llastiqet dhe monedhat turke (asnjëherë s'e kishim bërë kaq shpejt ndarjen, gjë që tregonte se që të dy e kishim mendjen gjetkë), midis nesh ra një heshtje e shkurtër, shurdhuese dhe plot pritje. Pastaj, siç na ndodhte shpesh, që me një vrull të verbër bënim pikërisht atë që nuk dëshironim,... në kohën kur u duk se e lamë fisnikërisht në harresë, pa e prishur urën e fundit, në një gojë, me një tërbim të pashpjegueshëm, shkatërrimtar thamë: "Po romanin?"

Merrej me mend se, gjersa fjala "roman" u përmend, kjo do të thoshte se atij i kishte ardhur fundi. E ndamë pa asnjë mëshirë, duke i shqyer kapitujt dhe fletët dhe në krye të disa minutave e çuan lojën gjer në fund.

Ismail Kadare

Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego nëse:

- Autori i tregimit ka zbatuar normat drejtshkrimore
 Autori nuk ka zbatuar normat drejtshkrimore

4. Lexo me kujdes fjalitë e mëposhtme dhe rretho cila prej tyre është fjali urdhërore:
Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- Linda gatuan.
- Cili është vëllau yt?
- Jon, lexo me zë të lartë!

5. Në fjalët e dhëna:

drejtëz, fshikëz, lidhëz, pjesëz, thonjëza, verdhëza, blerës, çelës, gjykatës, nxënës,

Nëse zanorja -ë e këtyre fjalëve është paratheksore, ngjyros rrethin para kolonës paratheksore (saktë), nëse është pastheksore, ngjyros rrethin para kolonës pastheksore (saktë):

| | saktë | pasaktë |
|--------------|-----------------------|-----------------------|
| Paratheksore | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |
| Pastheksore | <input type="radio"/> | <input type="radio"/> |

6. Cili është libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe?
Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

- “Meshari” - Gjon Buzuku;
- “Çeta e profetëve” - Pjetër Bogdani;
- “E mbësuarë e krishterë” - Lekë Matrënga;

7. Më poshtë janë dhënë gjashtë autorë dhe gjashtë vepra letrare. Sipas lidhjes së dhënë, jo të gjitha opsionet janë të sakta.

Ngjyros rrethët vetëm përpara përgjigjeve/opsioneve të sakta:

- Ismail Kadare Ura me tri harqe
- Naim Frashëri Andrra e jetës
- Migjeni Luli i vocërr
- Nazmi Rahmani Lulet e verës
- Ndre Mjeda Malësorja
- Petro Marko Shpella e piratëve

8. Lexo tekstin e mëposhtëm.

Ngjyros rrethin para përgjigjes që tregon figurën stilistike që ka përdorur autori:

Porsi kanga e zogut t'verës,
qi vallzon n'blerim të prillit;
porsi i ambli fladi i erës,
qi lmon gjit e drandofillit;
porsi vala e bregut t'detit,
porsi gjama e rrfes zhgjetare,
porsi ushtima e nji tërmetit,
ngjashtu a gjuha e jonë shqyptare.

- hiperbola personifikimi krahasimi simboli

9. Duke ngjyrosur rrethin para përgjigjes së saktë, trego cilit lloj të gjinisë letrare i përket vjersha në vijim:

Pylli qan për sorkadhen

*Sorkadhen e zunë në çark një mbrëmje,
Kur ngrihej pas fletëve ylli,
Natën me mall e me dhembje
Sorkadhen e re e kërkonte pylli.*

*Kur dita niste të feksë,
Sa mbyllej syri i yllit,
Rënkoinin drurët me vesë
Dhe s' ishte vesë! Ishin lotët e pyllit....*

Dritëro Agolli

- Lirikës
 Epikës
 Dramës

10. Shembull: Përshkruaj shokun apo shoqen.

Plotëso vendin bosh në vijat e mëposhtme:

11. Shiko me vëmendje fjalët e dhëna më poshtë.
Ngyros rrethin vetëm para fjalëve të përngjitura.

- Zemërgjerë
- Asnjëherë
- Gjithmonë
- Frymëmarrje
- Njëmbëdhjetë
- Tungjatjeta

12. Shiko me vëmendje fjalët pas rrathëve të zbrazët. Aty janë dhënë disa nga dhjetë klasët e fjalëve.
Ngyros rrethin përpara pjesëve që janë të ndryshueshme (pjesët e ndryshueshme të ligjëratës):

- parafjala
- emri
- folja
- lidhëza
- mbiemri
- përemri
- ndajfolja
- numërori

13. Foljen e nënvizuar në fjali lidhe me formën e pashtjelluar foljore gjegjëse.

Ata shkonin në shkollë duke kënduar.

Pjesore

Mbrëmë nuk kam fjetur deri vonë.

Paskajore

Nëna nxitoi hapat për të arritur të vegjëlit!

Përcjellore



14. Çfarë fjalie është shembulli në vijim.

Qyteti është populluar shumë vitet e fundit, prandaj janë ndërtuar shumë shtëpi të reja.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

- Fjali e përbërë me bashkërenditje shtuese
- Fjali e përbërë me bashkërenditje kundërshtuese
- Fjali e përbërë me bashkërenditje veçuese
- Fjali e përbërë me bashkërenditje përmbyllëse

15. Ngjyros rrathët përpara opsioneve të dhëna saktë, vetëm përpara atyre ku përputhet emri autorit, titulli i veprës dhe personazhi kryesor.

- Nazmi Rrahmani – Malësorja – Hajrija
- Vehbi Kikaj – Sarajet e Bardha – Mirusha dhe Fatosi
- Josip Relja - Nita – Shpendi
- Andon Z. Çajupi - Katërmbëdhjetë vjeç dhëndërr – Vangjeli
- Rifat Kukaj – Lugjet e Verdha – Ajkuna
- Petro Marko - Qyteti i Fundit - Anita



16. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm dhe duke nënvizuar disa fjalë, veço disa prej tyre (më së paku pesë) që ti mendon se janë kyçe për këtë tekst:

Si janë alienët?

Mendohet se ekzistojnë disa lloje alienësh, por më të njohurit janë ata me ngjyrë gri, të cilët kanë trup të vogël, me një gjatësi sa pothuajse një e dyta e trupit të një njeriu normal. Janë ngjyrë gri dhe pa qime në lëkurë. Koka e alienëve gri është e përbërë nga dy sy të mëdhenj e të zinj së bashku me dy veshë të mprehtë e të mëdhenj. Nuk kanë hundë, po në vendin e saj ndodhen dy vrima. Njëlloj tjetër alieni janë "alienët arianë". Quhen me këtë emër sepse hamendësohet se ngjajnë nga paraqitja me njerëzit nordikë. Ata mendohet se vijnë nga hyjësia e dietit. Sipas ufologëve, alienët nordik mendohet se kanë paraqitje njerëzore, me lëkurë të bardhë e të zbehtë, buzë pa ngjyrë dhe flokë shumë të verdhë, thuajse në të bardhë. Ata janë shumë të bardhë dhe të gjatë dhe shumë të pashëm. Duket se ka një ndarje ndëroqeanike të alienëve. Në SHBA në 75 % të rasteve, njerëzit raportojnë se kanë parë një alien gri, ndërsa në Europë rastet më të shumta të raportimit kanë të bëjnë me alienë nordikë.

.....

Plotëso vendin bosh në vizën e mëposhtme:

17. Ngjyros rrethin poshtë fjalëve që janë shkruar sipas rregullave të gjuhës letrare.

qumësht



xham



kaçavidë



lluster



patika



leckë



18. Në fjalinë e mëposhtme, ngjyros rrethin poshtë fjalisë së varur.

Filmi ishte i bukur por i frikshëm, siç e mendoja unë.



19. Në një roman nga planprogrami juaj shkollor përshkruhet fati i mjerë i femrës shqiptare për fatin e së cilës vendosin të tjerët dhe gjakmarrja kanunore. Lexo fragmentin më poshtë. Kujdes, detyra është e ndarë në dy pjesë:

...Sa shumë e ndryshuan Hajrinë ato tetëmbëdhjetë vjet të martesës së dytë, habitej edhe ajo vetë. Nëpër fytyrën dikur të njomë e të bukur, të shëndoshë e të plotë, si lulja në mëngjesin e pranverës plot rreze të këndshme dielli, ishin kryqëzuar tash do rrudha që ia kishin bërë koha dhe vuajtjet, thua se në atë mënyrë i kishte shënuar çdo vuajtje kujtimet e veta me nga një rrudhë në fytyrën e saj. Të gjitha ato kishin marrë tash pamjen e një rrjete marimange në ndonjë qoshe të çardakut. Edhe trupit i saj, dikur i hollë e i gjatë si selvia në mes të malit, ishte kërrusur pak, tash dukej më e vogël. Sytë i ishin zgjeruar e flokët, dikur aqë të zezë e të gjata, sa të gjitha shoqet ia lakmonin, ishin thinjur e rralluar. Megjithatë, Hajria, mu tash, në këto vite pleqërie, e ndjente veten më krenare se kurr ndonjëherë më parë.

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Pjesa e parë e detyrës: Fragmenti është nxjerrë nga romani:

- “Malësorja” - Nazmi Rrahmani
- “Toka e përgjakur” - Nazmi Rrahmani
- “Pas vdekjes” - Nazmi Rrahmani

Ngjyros rrethin para përgjigjes së saktë.

Pjesa e dytë e detyrës: Personazhi kryesor në këtë roman është:

- Bajrami
- Isufi
- Hajria

20. Ngjyros rrethin përpara përgjigjes së saktë.

Personifikimi është:

- figurë stilistike me anën e së cilës sendit (ose kafshës) i vishen tiparet e njeriut, gjërat pa shpirt e pa vetedije paraqiten sikur mendojnë,veprojnë e flasin si njerëz.
- vënia ballë për ballë e dy anëve, dy gjendjeve, dy pamjeve, dy dukurive të kundërta, që të dalë më shprehës e më në pah mendimi i autorit
- është vënia ballë për ballë e dy dukurive, dy sendeve a dy frymorëve të ngjashëm nga ana e jashtme, për të ndriçuar më mirë njërin prej tyre, për ta bërë më të gjallë e më të pasur mendimin.



Republika e Serbisë
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E
ZHVILLIMIT TEKNOLOGJIK
ENTI PËR VLERËSIMIN E CILËSISË SË
ARSIMIT DHE TË EDUKIMIT

EKZEMPLAR PËR SHKOLLËN

TË NGJITET TIKETA E IDENTIFIKIMIT

PROVIMI PËRFUNDIMTAR NË FUND TË ARSIMIT DHE EDUKIMIT FILLOR

TESTI
GJUHË SHQIPE

FORMULARI I IDENTIFIKIMIT

EMRI, EMRI I NJËRIT PRIND/PËRFAQËSUESIT TJETËR LIGJOR, MBIEMRI I NXËNËSIT

NUMRI I IDENTIFIKIMIT TË NXËNËSIT

| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|
| | | | | | | | |
|--|--|--|--|--|--|--|--|

SHKOLLA FILLORE _____
VENDI _____
KOMUNA _____

NËNSHKRIMI I MËSIMDHËNËSIT KUJDESTAR